

KOMITETI DREJTUES

Nr. 20 Prot.

Tiranë, 4 mars 2024

Vendim Nr. 2 i KD-së

Komiteti Drejtues i FSHB-së në mbledhjen e sajë më datë 1 mars 2024, drejtuar nga Presidenti, z. Avni Ponari, me prezencë të anëtarëve, znj. Edera Alibegaj, znj. Migena Plasa, z. Juel Jarani, si dhe z. Klevis Kaso, duke formuar kuorumin e domosdoshëm për zhvillimin e mbledhjes, diskutuan mbi rendin e ditës si vijon:

1. Shoqatat e reja që kërkojnë statusin e shoqatës kandidate për anëtarësim;
2. Trajtimi i financiar i Komisioneve të FSHB-së;
3. Shpërndarja e Fondit Grand akorduar nga MAS për vitin 2024;
4. Ndryshim i qytetit pritës për eventin europian U16 djem, 9-14 korrik 2024;
5. Organizimi i Ligës Unike Final 8 Meshkuj, 27-31 Mars 2024;
6. Bashkëpunimi i FSHB-së lidhur me kompaninë për prodhimin e Uniformave të ekipeve kombëtare;
7. Të ndryshme.

Komiteti Drejtues diskutoi sipas rendit të ditës duke trajtuar problematikat për secilën pikë të sajë.

Për sa më sipër KD-ja vendosi:

1. Pranim të kërkesës së shoqatave “Skills Basketball Academy” dhe “Galaktikking” për fitimin e statusit “Shoqatë Kandidate për Anëtarësim”;
2. Komisioni i Apelit;
 - 2.1 Përcaktim të trajtimit financiar për Komisionin e Apelit në vlerën neto 7'000 lek për anëtar, për çdo mbledhje të zhvilluar;
 - 2.2 Ndryshim i nenit 11.8 i Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit, duke ndryshuar afatin e apelimit nga 5 ditë dhe duke e përshtatur sipas Statutit të FSHB-së ku përcaktohet afati i apelimit brenda 72 orëve nga marrja e njoftimit;
 - 2.3 Ndryshim i nenit 11.2 i Rregullores së Aktiviteteve Kombëtare të Basketbollit:

Ishte: “Në të gjitha rastet, protestat, ankesat dhe apelimet, ashtu si edhe pagesa e tyre, duhet të adresohen në FSHB. Nëse nuk merren parasysh, shuma e paguar nuk kthehet, nëse merren parasysh, shuma e paguar kthehet plotësisht.”

Bëhet: “Në të gjitha rastet, protestat, ankesat dhe apelimet, ashtu si edhe pagesa e tyre e pa rimbursueshme, duhet të adresohen në FSHB.”

3. Shëpërndarjen e Fondit Grand të akorduar nga MAS për vitin 2024 sipas propozimit të financës për mbulimin pjesor të aktiviteteve kalendarike kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Përcaktimin e Tiranës si qyteti pritës i eventit europian U16 djem, 9-14 korrik 2024, duke marrë në konsideratë mundësitë më të mira për akomodim të ekipeve mike. Për këtë u udhëzua administrata e FSHB-së për nisjen e koordinimit me FIBA-n për këtë ndryshim;
5. Organizimin e Ligës Unike Lajthiza Final 8 Meshkuj në qytetin e Vlorës. Për këtë aktivitet i cili do të organizohet më 27 deri 31 mars 2024, do të bashkëpunohet me Bashkinë e Vlorës, Klubin Sportiv Flamurtari, si dhe me mbështetjen e kompanisë së ujit Lajthiza Grup. Udhëzohet administrata e FSHB-së, që në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë dhe Klubin Sportiv Flamurtari, të ndërtojë një grup pune për mirëorganizim të eventit duke realizuar programin e detajuar.
6. Udhëzim i administratës për vlerësim të mundësive më të mira për sigurimin e bazës materiale për ekipet kombëtare duke pritur ofertën e kompanisë aktuale bashkëpunuese, Macron;
7. Të ndryshme;
 - 7.1 U diskutua lidhur me kërkesën adresuar Komitetit Drejtues nga disa përfaqësues të shoqatave anëtare lidhur me kërkesën për heqjen e dënimit me përjashtim të përjetshëm për ish lojtarin Bruno Daliu. Komiteti Drejtues vendosi të trajtoi këtë kërkesë në mbledhjen e ardhshme duke marrë më shumë informacion lidhur dhe me qëndrimin e ish gjyqtarit të FSHB-së të përfshirë në këtë çështje;
 - 7.2 Udhëzim administratës së FSHB-së për përgatitjen e një programi për promovimin e basketbollit tek fëmijët më datë 1 qershor 2024, duke siguruar shtrirje sa më të gjerë territoriale në Shqipëri.

Avni Ponari
President

Franko Bushati
Sekretar i Përgjithshëm